

## Jeni ju si prindër të shqetësuar për zhvillimin e fëmijës suaj?

### *Ju vëreni që fëmija juaj*

- si foshnjë qanë shumë dhe nuk qetësohet lehtë
- si foshnjë lëvizë shumë pak
- vetëm pak gjëra të ndryshme mer në dorë
- rrallë mund të luajë vetë
- është i paqetë dhe rrallë mund të koncentrohet për një kohë më të gjatë në ndonjë gjë
- është tepër i rezervuar (i tërhequr), tregohet me ankth apo nuk sheh rreziqe
- ka nevojë për shumë kohë për të mësuar diçka të re
- nuk interesohet për fëmijë tjerë (nga mosha 3 vjeçare)
- mezi që imiton veprimet, zërat apo fjalët

## Jeni ju si prindër të pasigurt në edukim?

### *Ju përjetoni që fëmija juaj*

- ka shumë apo aspak frikë nga të huajtë
- shpesh hyn në grindje me fëmijët tjerë
- nuk pranon fjalën „jo“ dhe shpesh duket që nuk ndëgjon
- nuk mund të ju përmbahet marrëveshjeve
- prish shumë gjëra
- tregon çaste zemërimi shumë të dhunshme
- nuk mund të rrijë qetë i ulur

## Jeni ju si prindër të shqetësuar për zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit të fëmijës suaj?

### *Ju vëreni që fëmija juaj*

- si foshnjë prodhon pak zëra, bën pak guga
- ka vështirësi të shprehet, flet pak
- bëlbëzon
- i lë shumë shkronja në një fjalë
- nuk krijon ende fjali të thjeshta
- mezi kuptohet dhe ndjehet i përjashtuar
- shpesh nuk merret vesh

Ju dëshironi të kuptoni pse sillet fëmija juaj kështu dhe si mund ta ndihmoni fëmijën tuaj në mënyrë pozitive? Ju dëshironi një këshillim personal dhe profesional; atëherë edukimi i hershëm specia (Heilpädagogische Früherziehung) mund të jetë një ofertë që do të ju qëndrojë afër me këshilla dhe veprime. Informata ju jep zyra për edukim të hershëm në kantonin tuaj. Adresat i gjeni [këtu](#).